

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prestigjozja amerikane Newsweek: Si lufta ligjore kundër Trump-it dhe Veliajt është kthyer në model glob al
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/prestigjozja-amerikane-newsweek-si-lufta-ligjore-kunder-trump-it-dhe-ve-i585321
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 07:43:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 07:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d7f4066e4662acd417a41773a07f13d634b2b92f3fe16c831fe34a973da21034
TEKSTI	31c3dd83ba44d474f75d9ebc5f4e689d14b4889982c91fb54185e9ab27d8eefd
PAMJA	a17a5351d385b63343db6bcf95af49dd5ce6423b526b1a1a997b04d738cb24f3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5ae2807fd0b6cdab12f4fa6513a0b80c5b4e050e3f22e839a2012622c8bc6ae6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5ae2807fd0b6cdab12f4fa6513a0b80c5b4e050e3f22e839a2012622c8bc6ae6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Iran synon të kontrollojë kontaktet me të huajt, projektligji për "infiltrimin" nxjerr në pah përçarjet brenda establishmentit/25 vjet nga sulmet terroriste të 11 shtatorit në SHBA, Begaj; Kujtesë kollektiviteti

Prestigjiozja amerikane Newsweek: Si lufta ligjore kundër Trump-it dhe Veliajt është kthyer në model global

11 Shtator 2026, 09:45Politika TEMA



Prestigjiozja amerikane Newsweek: Si lufta ligjore kundër Trump-it dhe

Revista prestigjioze amerikane Newsweek i ka kushtuar një opinion çështjes së paraburgimit prej më shumë se 18 muajsh të Kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj.

Në një opinion të shkruar nga një prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Presidentit të SHBA, Donald Trump, ish i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për Lindjen e Mesme, Jason D. Greenblatt, ai shprehet se mbajtja në paraburgim pa dënim e Veliajt është një fenomen që lidhet me përdorimin e drejtësisë si armë kundër kundërshtarëve politikë; fenomen që, sipas autorit, është vënë re edhe te Presidenti Trump para se të fitonte mandatin e dytë.

Në shkrimin e botuar posaçërisht për Newsweek, Jason D. Greenblatt vë në pah se vetë SPAK-u, institucioni i krijuar me mbështetje perëndimore për të luftuar korrupsionin, është sot ai që ngre pikëpyetjet më të mëdha mbi shtetin e së drejtës, me një sistem gjyqësor të mbingarkuar dhe një nga normat më të larta në Evropë të paraburgimeve pa gjykim.

Duke iu referuar vlerësimeve të Komisionit të Venecias dhe DASH, Greenblatt argumenton se rasti Veliaj po dëmton si besueshmërinë në demokracinë e Shqipërisë, ashtu edhe pamjen e saj në sytë e investitorëve të huaj. Ai del në përfundimin se reforma në drejtësi nuk mund të konsiderohet e plotë derisa edhe vetë prokurorët t'i binden të njëjtit ligj që zbatojnë.

Por kush është Jason D. Greenblatt? Ai është avokat, diplomat dhe bashkëpunëtor i vjetër i Presidentit Trump. Në vitin 1997 ai u bashkua me Trump Organization, ku kaloi rreth dy dekada si Zëvendëspresident Ekzekutiv dhe Drejtor i Departamentit Ligjor, duke mbikëqyrur marrëveshje të mëdha pasurish.

Në 2017, Presidenti Trump e emëroi Jason D. Greenblatt si të Dërguar të Posaçëm të Shtëpisë së Bardhë për Lindjen e Mesme, post që mbajti deri në largimin e tij në 2019. Në atë rol ishte një nga arkitektët kryesorë të planit "Peace to Prosperity" mes Izraelit dhe Palestinezëve dhe luajti rol kyç në hedhjen e themeleve për Marrëveshjet e Abrahamit (2020), përmes të cilave Izraeli normalizoi marrëdhëniet me Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahreinin, Sudanin dhe Marokun. Që nga 2023 është Drejtor i Lartë për Diplomacinë Arabo-Izraelite pranë Jerusalem Center for Security and Foreign Affairs.

Artikulli i plotë:

Nga Jason D. Greenblatt

Në shkurt 2025, prokurorët shqiptarë arrestuan Erion Veliajn, kryetarin e Bashkisë së Tiranës për tre mandate. Tetëmbëdhjetë muaj më vonë, ai është ende në burg. Ai nuk është dënua për asgjë. Paraburgimi i tij thjesht është rinovuar herë pas here, ndërsa gjykatat shqiptare debatojnë nëse ky paraburgim është i ligjshëm apo jo. Kryeqyteti i një aleati të NATO-s po qeveriset pa drejtuesin që zgjedhësit e tij e kanë votuar tri herë.

Amerikanët kanë një shprehje për këtë. E quajmë "luftë ligjore" (lawfare): përdorimin e prokurorëve, gjykatave dhe proceseve ligjore pa fund për të larguar një kundërshtar politik. Kjo praktikë nuk ka qenë kurrë ekskluzivisht amerikane. Tani po shfaqet në vende të ndryshme, dhe Shqipëria ka prodhuar një nga shembujt e saj më të spikatur.

Ajo çka e veçon rastin shqiptar është se kush po e bën këtë. Prokurorët që kërkojnë ta mbajnë kryebashkiakun në paraburgim i përkasin Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të njohur si SPAK, e krijuar në 2016 me mbështetjen amerikane dhe evropiane si boshti kryesor i një reforme të gjerë në drejtësi. Shqipëria kishte nevojë për atë reformë. Korrupsioni kishte rrënjë të thella në jetën publike dhe rrjetet kriminale shfrytëzonin institucionet e dobëta. Teoria ishte e thjeshtë: një sistem drejtësie më i fortë do të prodhonte qeverisje më të pastër, besim më të madh publik, më shumë investime dhe një rrugë më të shpejtë drejt Bashkimit Evropian. Në vend që të ndodhte kjo, tani është institucioni i ndërtuar për të mbrojtur shtetin e së drejtës ai që ngre pikëpyetjet më të vështira për të.

Një dekadë më vonë, rezultatet janë të vështira për t'u mbrojtur. Deputeti Keith Self nga Teksasi, kryetar i Nënkomitetit për Evropën pranë Komisionit të Punëve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, ka vërejtur se numri i çështjeve të pazgjidhura gjyqësore është rritur nga rreth 16,000 në një vlerësim prej 200,000.

Qytetarët mund të presin deri në 15 vjet për një vendim përfundimtar. Më shumë se gjysma e popullsisë së burorur është në pritje të gjyqimit - një nga normat më të larta në

Evropë. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e trajton paraburgimin si një masë të jashtëzakonshme që duhet justifikuar rast pas rasti: rrezik arratisjeje, ndërhyrje në prova apo dëshmitarë, ose rrezik për vepra të reja. Në Shqipëri, kjo është bërë praktikë standarde.

Kjo është ajo që i ndodhi kryebashkiakut të Tiranës. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës e studioi pikërisht këtë praktikë në shtetet anëtare. Përfundimi i tij ishte i qartë: kur burgosja e kryebashkiakëve para gjykimit çon në pezullimin apo zëvendësimin e tyre automatik, kjo dëmton prezumimin e pafajësisë, mbytet pluralizmi politik dhe u heq qytetarëve përfaqësimin që kanë zgjedhur. Një urdhër paraburgimi, jo një vendim gjyqësor, e ka penguar udhëheqësin e zgjedhur të qytetit më të madh të Shqipërisë të kryejë punën që i besuan zgjedhësit e tij.

Kur prokurorët kanë prova të besueshme për shkelje, ata duhet t'i ndjekin ato kudo që të çojnë, madje edhe brenda bashkisë. Ata gjithashtu duhet të përgjigjen edhe vetë para ligjit. Një fushatë kundër korrupsionit e ruan legjitimitetin e saj vetëm përdërisa respektin procesin e rregullt ligjor, dhe mbajtja e një njeriu në qeli kaq gjatë, pa vendim gjyqësor, nuk e përmbush këtë standard. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka vendosur dy herë në favor të kryebashkiakut, së pari duke mbrojtur mandatin e tij të zgjedhur dhe më pas duke urdhëruar një rishikim nëse mbajtja e tij në burg është krejt e justifikuar.

E njoh mirë këtë stil. Kalova pothuajse një çerek shekulli duke punuar për Presidentin Donald Trump, fillimisht në biznes e më pas në Shtëpinë e Bardhë si i dërguari i tij për Lindjen e Mesme. E kam vëzhguar, si nga brenda rrethit të tij ashtu edhe nga jashtë, se si prokurorët dhe aleatët e tyre politikë kaluan vite duke u përpjekur të fitonin përmes procesit ligjor atë që nuk mund ta fitonin në kutinë e votimit. Në fund, zgjedhësit e vendosën çështjen.

Vende të tjera po jetojnë versionet e tyre të kësaj historie. Izraelitët kanë debatuar prej vitesh mbi ndjekjen penale të Kryeministrit Benjamin Netanyahu. Argentinasi po debatojnë sot mbi hetimet e drejtuara kundër Presidentit Javier Milei. Francezët kaluan vitin e shkuar duke pritur të mësonin nëse një gjykatë do ta mbante Marine Le Pen jashtë fletës së votimit presidencial. Brazilianët po zhvillojnë të njëjtën betejë mbi burgosjen e ish-Presidentit Jair Bolsonaro. Çdo rast ka faktet e veta dhe çdo vend do ta gjykojë vetë. Modeli është ai që duhet të na shqetësojë: në të gjithë botën demokratike, akuzat penale janë bërë armë të luftës politike, dhe objektivat janë shpesh vetë drejtuesit që zgjedhësit zgjedhin.

Perëndimi ka një arsye të veçantë për të vëzhguar Shqipërinë; ndihmuan në krijimin e SPAK-ut, dhe besueshmëria e tij qëndron pas tyre. Kur një sistem drejtësie mban një kryebashkiak të zgjedhur muaj pas muaji pa një dënim, kjo i jep municion çdo autokrati që pretendon se retorika perëndimore për shtetin e së drejtës është selektive.

Dëmi është ekonomik po aq sa politik. Puna ime më ka tërhequr kohët e fundit drejt Ballkanit, ku kam qenë duke eksploruar me kujdes mundësi për të parë nëse është një rajon ku klientët e mi duhet të ndihen rehat të bëjnë biznes, prandaj i kushtoj vëmendje mënyrës si kompanitë e vlerësojnë vendin. Raporti i vitit 2025 i Departamentit të Shtetit mbi klimën e investimeve i njeh Shqipërisë potencial të gjerë ekonomik, por gjen se investitorët e konsiderojnë ende një vend të vështirë për të bërë biznes, duke përmendur korrupsionin në gjyqësor dhe prokurimin publik, zbatimin e dobët të kontratave, pastrimin e parave dhe rregulloret në ndryshim të vazhdueshëm. Drejtuesit e bizneseve nuk kanë nevojë të ndjekin nga afër politikën shqiptare. Një titull lajmi për një kryebashkiak të mbajtur një vit e gjysmë pa vendim gjyqësor e bën vetë këtë punë, dhe investimi, partneriteti apo zgjerimi shkon në heshtje diku tjetër, më të parashikueshëm. Zyrtarët që nënshkruajnë urdhrat e paraburgimit nuk do ta ndiejnë atë humbje. Shqiptarët e thjeshtë do ta ndiejnë, në vende pune që s'krijojnë kurrë dhe paga që s'paguhen kurrë.

Shqipëria nuk duhet të zgjedhë mes luftës kundër korrupsionit dhe mbrojtjes së shtetit të së drejtës. Vendet që ia dalin i bëjnë të dyja gjërat, sepse njëra varet nga tjetra. Një dekadë më parë, Shqipëria u nis t'ua merrte pushtetin e pakontrolluar të korruptuarve. Kryebashkiaku i kryeqytetit të saj sot ndodhet në burg, pa vendim gjyqësor, sepse ai pushtet nuk u zhduk kurrë. Ai u zhvendos në zyrën e prokurorisë. Shqipëria duhet ta përfundojë atë që reforma ishte menduar të arrinte: që të gjithë, përfshirë luftëtarët kundër korrupsionit, të zbatojnë ligjin.

Link i artikullit original: <https://www.newsweek.com/how-lawfare-waged-against-trump-became-global-playbook-opinion-12414601>

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[25 vjet nga sulmet terroriste të 11 shtatorit në SHBA, Begaj: Kujtesë kolektive që ka riformësuar jetët tona! Amerika i tregoi botës se nuk mposhetet nga asgjë](#)

09:25 Politika

[Dy reparte ushtarake marrin 271 mln euro investime këtë vit, 37% të buxhetit të mbrojtjes](#)

08:25 Politika

[“S’ka luftë mes qeverisë dhe gjyqësorit”, deputetja e PS: Do miratohet ligji, magjistratët të ishin pak më të duruar](#)

21:05 Politika / 13 komente

[Balla në Paskuqan: 43 shkolla e kopshte të reja në Kamëz, rezultatet e PISA 2025 konfirmojnë transformimin e arsimit](#)

19:25 Politika / 6 komente

[Ambasadori gjerman: Reforma në drejtësi faktor kyç në avancimin e Shqipërisë drejt BE-së](#)

19:15 Politika / 5 komente

[‘Kallëzim se po zbatoj ligjin’, ministri Malaj publikon pagat që kërkojnë magjistratët: Efekti në buxhet arrin në 40 milionë euro shtesë çdo vit](#)

19:05 Politika / 64 komente

[Padia e gjyqtarëve për pagat, metafora e reformës së deformuar](#)

16:55 Politika / 15 komente

[Tabaku me përfaqësuesit e World Economic Forum: Shqipëria ka potencial, por kapitalet e dyshimta po deformojnë tregun](#)

16:10 Politika / 11 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këllicin: Ky idioti po mbron Ramën](#)

15:45 Politika / 24 komente

[Sara Mila në Shkup: BE nuk është vetëm kapituj të mbyllur, por ndryshime reale për qytetarët](#)

15:40 Politika / 15 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 17 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këllicin: Ky idioti po...](#)

15:45 Politika / 24 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “afërën e armëve” m...](#)

15:30 Dossier / 7 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 50 komente

'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...

19:05 Politika / 64 komente

Blog Tema

Një telash më shumë për Partinë Demokratike

19:10 Blog / 17 komente

Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin

18:28 Blog / 27 komente

Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë

17:05 Blog / 7 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by [Tomorrow.io](#)

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by